

E DREJTA PËR INFORMIM

Vetëdeklarimi i autoriteteve publike për vitin 2025

Zyra e Komisionerit në zbatim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) ushtron funksionet kontrolluese/mbikëqyrëse mbi autoritetet publike, evidentimin e problematikave në zbatimin e kuadrit rregullator, si dhe nxit rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së tyre përballë publikut, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit apo medias.

Në këtë kontekst, në përputhje me nenin 24/1 “Detyrimi për bashkëpunim” të LDI, Komisioneri ka dalë me Urdhërin nr. 1, datë 05.01.2026 “Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike mbi zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025”. Bashkëpunimi i autoriteteve publike me Zyrën e Komisionerit përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit praktik të së drejtës për informim dhe përmbushjen e qëllimit të LDI.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARËNCËS

Nr. 19 prout Tiranë, më 05.01.2026

UKDHËR

Nr. 1, datë 05.01.2026

PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE
PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVIT TË LIGHT PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT PËR VITIN 2025

Në mbledhjetë të datë 24.11 të ligjit nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- Miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike për vitin 2025, bashkëlidhur këtij urdhëri dhe pjesë përberëse e tij.
- Të gjitha autoritetet publike janë përgjegjëse për raportimin e saktë të të dhënave dhe dërgimin e raportit brenda datës 31 janar 2026.
- Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit për dërgimin e formatit të raportimit të gjitha autoriteteve publike, mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe publikimin e tyre.

Ky urdhër hyr në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

"Adresa: "Rr. Abdi Toptani, 5415 Tiranë" Telefonat: 069 2221236 www.ajpa.al/ajpaqkq

[illegible]

Plotësimi i këtij pyetësori me të dhëna të sakta dhe të përditësuara është një detyrim për çdo autoritet publik, në mënyrë që Zyrës së Komisionerit t'i vihet në dispozicion i gjithë informacioni i domosdoshëm për përmbushjen e kompetencave të saj ligjore. Dokumenti është i përbërë nga 16 pyetje, të cilat mbulojnë plotësisht procesin e trajtimit të kërkesave për informim dhe mbajtjen e të dhënave në lidhje me të.

Periudha raportuese është janar-dhjetor 2025 dhe pyetësi i plotësuar i dërgohet në rrugë zyrtare dhe/ose elektronike Zyrës së Komisionerit brenda datës 31 janar të vitit 2026. Të dhënat që mbliidhen nga ky pyetësor janë të dhëna publike dhe përbëjnë informacion publik sipas LDI dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe publikohen në formën/formatin që i raportohen Zyrës së Komisionerit. Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit do të publikohen/përditësohen dhe në portalin *pyetshtetin.al* dhe do të qëndrojnë për aq kohë sa do të ushtrohet kjo kompetencë.

Edicioni i 17-të i ICIC, mbledhje e Komitetit të Planifikimit

Nën drejtimin e Zyrës së Komisionerit u zhvillua mbledhja e dytë on-line e Komitetit të Planifikimit për organizimin e edicionit të 17-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), që do të mbahet në Sierra Leone. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues nga autoritetet homologe të vendit organizator të Konferencës së ICIC, të Buenos Airesit në Argjentinë, Australisë, Kanadasë, Gjermanisë, Filipineve, Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe nga “Qendra për Ligj dhe Demokraci” në Kanada.

Aktiviteti qendror botëror i fushës është vendosur të zhvillohet në periudhën 28-30 shtator 2026, me

bashkëpunimin e UNESCO, me të cilën ICIC vitet e fundit ka një bashkëveprim të konsoliduar, duke qenë se promovimi i kësaj të drejte globalisht mbulohet edhe nga kjo organizatë. Në këtë mënyrë, parashikohet që në kuadër të Konferencës së 17-të të kremtohet edhe 28 Shtatori - Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim, si një mundësi për të nxitur forcimin e kulturës së transparencës së autoriteteve publike kudo në botë. Më 29 shtator do të mbahen një Ditë/Sesion i Hapur me komunitetin ndërkombëtar të fushës dhe aktorë/organizata të tjera të rëndësishme si të kontinentit ashtu edhe më gjerë, ndërsa më datën 30 shtator do të zhvillohet Sesioni i Mbyllur i Konferencës ku do të përcaktohen prioritetet e punës së ICIC.



Pjesëmarrësit në këtë takim të Komitetit të Planifikimit u njohën me planin e masave të prezantuar nga autoriteti organizator dhe diskutuan gjerësisht mbi përmirësimin tij, duke mbajtur në konsideratë të gjitha sugjerimet për aspektet përmbajtësore, logjistike dhe procedurale të Konferencës. Po ashtu, është rënë dakord që në zbatimin e këtij plani të ofrohet e gjithë asistencë e domosdoshme për vendin organizator në kapërcimin e problematikave që mund të verifikohen hap pas hapi, për arritjen e objektivit në organizimin e një aktiviteti të suksesshëm dhe cilësor.

Në këtë edicion të 17-të të ICIC, organizatorët kanë parashikuar mbajtjen e një numri të lartë takimesh për shkëmbimin e ideve dhe krijimin e urave të bashkëpunimit mes autoriteteve të fushës dhe organizatave të shoqërisë civile në promovimin e të drejtës për informim. Ndërkohë, procesi informues për anëtarësinë e ICIC mbi çështjet kryesore organizative dhe datat e zhvillimit të Konferencës së 17-të do të realizohet në periudhën e afërt nga Sekretariati, ndërsa takimet e Komitetit të Planifikimit do të mbahen më shpesh dhe në mënyrë intensive.

Për informim të saktë shëndetësor, prezantimi i Raportit të organizatës “Together for Life”

Zyra e Komisionerit ka një bashkëpunim të konsoliduar me organizatën e shoqërisë civile “Together for Life” (TfL), e cila e ushtron veprimtarinë e saj kryesisht në monitorimin e institucioneve të sektorit shëndetësor. Së fundi, u prezantuan gjetjet e raportit “Përballja me dezinformimin shëndetësor dhe deepfake-et në epokën e inteligjencës artificiale”, një projekt i mbështetur nga See Check Network (rrjeti i Evropës Juglindore kundër keqinformimit) dhe me financimin e Bashkimit Evropian.

Ndër të dhënat kryesore të raportimit të TfL vlerësohet se 9 në 10 qytetarë të pyetur kanë rënë pre e dezinformimit shëndetësor gjatë përdorimit të internetit dhe/ose platformave të komunikimit social. Ndërkohë, mbi 60% e të anketuarve kanë deklaruar se obeziteti dhe sëmundjet tumorale kryesojnë si tematikat që targetohen për të shpërndarë lajme të rreme. Në këtë mënyrë, kërkohet një angazhim më i lartë nga institucionet publike të fushës për të forcuar veprimtarinë në parandalimin dhe adresimin ligjor në kufizimin e përhapjes së dezinformimit shëndetësor.



Në aktivitetin e prezantimit të gjetjeve të Raportit ishte e ftuar dhe Zyra e Komisionerit së bashku me përfaqësues nga autoritete publike, profesionistë të fushës, të organizatave të shoqërisë civile, medias, qytetarë etj., të cilët ndanë shqetësimet, qëndrimet dhe përvojat e tyre personale mbi këtë fenomen. Në kuptim të objektit të veprimtarisë, Zyra e Komisionerit theksoi si mjaft të rëndësishme qasjen e institucioneve në këtë sektor me përgjegjësi dhe etikë të shtuar në ofrimin e informacioneve të sakta, të kontrolluara dhe të besueshme. Nga ana tjetër, bashkëpunimi më efektiv institucional është rruga e duhur për adresimin e problematikave, paralelisht me forcimin e mbikëqyrjes ligjore. Dezinformimi shëndetësor duhet të trajtohet si çështje e shëndetit publik, duke kërkuar ndërhyrje të koordinuar, të menjëhershme dhe afatgjatë – u theksua, gjithashtu, në këtë aktivitet.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Vendimarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit janar 2026 ka dhënë një vendim në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas [vendimit nr. 1, datë 12.01.2026](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Fondit Shqiptar të Zhvillimit (në vijim “autoriteti publik” dhe/ose “FSHZH”) me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, përfaqësues i emisionit “Piranjat” (në vijim “ankuesi”), nëpërmjet kërkesës së datë 01.08.2025, depozituar në adresën elektronike adf@albanianadf.org, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me: strukturën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, emër dhe mbiemër të stafit, si dhe pozicionin e tyre në këtë strukturë.

Autoriteti publik, me e-mail-in datë 14.11.2025, ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar me pretendimin se: “Fondi Shqiptar i Zhvillimit është person juridik me status organizate jofitimprurëse, duke gëzuar pavarësi të plotë drejtuese, administrative financiare dhe teknike, organizatë e cila ka objekt të veprimtarisë nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor. Referuar këtij statusi juridik të veçantë, nuk është entitet buxhetor i administratës shtetërore. Bazuar në legjislacionin në fuqi, punëdhënësi nuk ka detyrim ligjor të japë të dhëna personale të punëmarrësve, pa pëlqimin e tyre të shprehur ose në rastet kur parashikohet ndryshe”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji dhe pas shqyrtimit paraprak të saj, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ajo përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI.

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Zyra e Komisionerit shkresërisht i kërkoj FSHZH të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar. Autoriteti publik, shkresërisht ka kthyer përgjigje, duke refuzuar dhënien e informacionit me pretendimin se: “argumentimi që ju jepni duke e konsideruar FSHZH si autoritet publik bazuar në shkronjën c) të pikës 1 të nenit 2 të LDI, i cili parashikon se: autoritet publik c) çdo person fizik ose juridik të cilit i është dhënë me ligj akt nënligjor ose çdo

lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”, nuk qëndron me arsyetimin ligjor si më poshtë. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, konkretisht të nenit 4 të tij ...Dispozitat e ligjit të sipërcituar kanë përcaktuar formën e organizimit, të rregullave të funksionimit dhe të administrimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit...Këto funksione janë tërësisht teknike dhe nuk përbëjnë ushtrim të autoritetit publik në kuptimin e LDI, pasi FSHZH nuk nxjerr akte administrative detyruese, nuk ushtron kontroll administrativ, nuk merr vendime që krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë të drejta e detyrime për publikun dhe nuk ushtron kompetenca autoritative. FSHZH nuk merr vendime detyruese për shtetasit, nuk jep licenca, nuk ushtron kontroll, nuk ushtron kompetenca tipike të një "Autoriteti Publik". Marrëdhëniet e FSHZH-së me subjektet e tjera bazohen në instrumente kontraktuale si marrëveshje financimi, bashkëpunime etj. duke e pozicionuar këtë organizatë si një njësi implementuese të projekteve dhe jo si "organ" apo "Autoritet" që ushtron funksione publike në kuptim të LDI. Në zbatim të parimit "ex specialis derogat legi gjeneral", dispozitat e ligjit të posaçëm kanë përparësi ndaj interpretimeve që mund të rrjedhin nga ligje të përgjithshme, siç është LDI, i cili vepron në mënyrë horizontale për autoritetet publike. Duke qenë se ligji i posaçëm e klasifikon FSHZH si organizatë jofitimprurëse me pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, pa kompetenca autoritative në ushtrimin e funksioneve publike, ai nuk mund të trajtohet si "autoritet publik", në kuptimin e nenit 2 të LDI. Si përfundim nga sa parashtruar më sipër, vlerësojmë se FSHZH nuk është subjekt i LDI, në raport me kërkesën që ka paraqitur subjekti emisioni "Piranjat" për vënien në dispozicion të strukturës me emrat dhe pozicionet individuale të punonjësve”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me e-mail, ka vijuar ankimin, duke kërkuar detyrimin e autoritetit publik për të vendosur në dispozicion informacionin sipas objektit të kërkesës për informacion. Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson, se argumentet e parashtruara nga autoriteti publik për mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nuk janë në përputhje me parashikimet e LDI.

Bazuar në ligjin nr. 10130/2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, neni 2 i tij përcakton fushën e veprimtarisë; neni 5 përcakton objektivat; neni 6 përcakton objektin e

veprimtarisë dhe kompetencat; ndërsa referuar shkronjave a), b) dhe c) të pikës 1 të nenit 8 të ligjit të sipërcituar përcaktohet, se: “Të ardhurat në buxhetin e FSHZH-së krijohen nga: a) fondet e përfituara nga marrëveshjet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm, për financimin e projekteve, të zbatuara nga FSHZH-ja; b) fondet nga Buxheti i Shtetit, nga individë dhe institucione, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas marrëveshjeve përkatëse; c) fondet nga bashkëfinancimi i përfituesve dhe i njësive të qeverisjes vendore;...”. Bazuar në ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, konkretisht të pikës 3 të nenit 2, “Organizata jofitimprurëse” kuptohet shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti”, si dhe të nenit 6 të tij “Parimi i pavarësisë nga shteti” përcaktohet se “Organizatat jofitimprurëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërore”.

Ndërkohë, LDI në pikën 1 të nenit 2, përcakton qartë se “autoritet publik”: a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, FSHZH edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10130/2009 harton strategji dhe menaxhon projekte, fondet e të cilave krijohen nga Buxheti i Shtetit dhe marrëveshjet e lidhura nga shteti shqiptar për përfitimin e granteve, huave, garancive dhe nuk përjashtohet si subjekt i LDI për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të LDI. Analiza e mësipërme, vjen në përputhje të plotë gjithashtu me përcaktimet e pikës “ç” të nenit 11, të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky qëndrim është konsoliduar nëpërmjet vendimit nr. 41/2020 dhe të vendimit nr. 24/2021 të Komisionerit, ky i fundit i lënë në fuqi dhe nga Gjykata Administrative e

Shkallës së Parë me nr. 2578/2021. Gjithashtu, në kundërshtim të pretendimeve të mësipërme, statusi i FSHZH, si subjekt i LDI është pranuar dhe nga vetë autoriteti publik, i cili në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8 dhe 10 të këtij ligji, ka publikuar në faqen zyrtare të tij Programin e Transparencës (https://www.albaniandf.org/prog_transp/). Ndërkohë, për sa i përket informacionit të kërkuar, mbi emrat e punonjësve të FSHZH, kjo gjen mbështetje në nenin 44 pika 2 e ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI. Rrjedhimisht, ekzistenca e tij, pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d) të LDI dhe Urdhrit nr. 280/2025 “Për miratimin e Programit model të Transparencës për autoritetet publike” të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë. Nga sa më sipër, autoriteti publik jo vetëm duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, por në zbatim të nenit 7 të LDI duhet që informacionin e kërkuar ta bëjë publik në mënyrë proaktive në Programin institucional të Transparencës. Zyra e Komisionerit thekson, se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Në këtë kontekst, sjellim në vëmendjen e FSHZH, se Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare, në lidhjen <https://idp.al/vendime-informimi/>, si vendimi nr. 32/2018; nr. 21/2021; nr. 23/2021; nr. 50/2021; nr. 19/2023, etj.

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të LDI; si dhe shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Komisioneri vendosi: a) pranimin e ankesës dhe b) urdhërimin e autoritetit publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit: “Strukturën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, emër dhe mbiemër të stafit, si dhe pozicionin e tyre në këtë strukturë”.